



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 20 JANAR 2020, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 17:00)

Rendi i ditës:

1. Hapja e sesionit VI të legjislaturës IX të Kuvendit të Shqipërisë
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 18.12.2019 *(neni 44, pika 2, i Rregullores)*
3. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*
4. Njoftimi për miratimin me mirëkuptim të programit të punës së Kuvendit për periudhën 20 janar - 7 mars 2020 *(neni 26 i Rregullores)*
5. Njoftimi për miratimin me mirëkuptim të kalendarit 3 - javor të punimeve të Kuvendit për

periudhën 20 janar - 7 shkurt 2020 *(neni 27 i Rregullores)*

6. Paraqitja në Kuvend i kalendarit të raporteve vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për veprimtarinë e vitit 2019 *(neni 103, pika 1, i Rregullores)*

7. Projektvendimi “Për zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” *(neni 147/d i Kushtetutës, neni 201, pika 2, shkronja “f”, i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 60 i Rregullores)*

(Në sallë këndohet himni kombëtar.)

Gramoz Ruçi - Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Sot nisim sesionin e ri parlamentar, që përkon me kremtimin e 100-vjetorit të parlamentarizmit shqiptar.

Një shekull më parë, kombi shqiptar ndodhej në një nga udhëkryqet më të vështira të ekzistencës së tij, por burrat e shquar të kombit më 21 janar 1920 u mbledhën në Kuvendin kombëtar të Lushnjës dhe morën vendime historike për të mos lejuar copëtimin e mëtejshëm të trungut kombëtar. Ata u betuan mbi flamurin kombëtar të pavarësisë, përsosën dhe plotësuan vendimet e Kuvendit kombëtar të Vlorës, ringritën institucionet përfaqësuese e qeverisë së shtetit dhe u dërguan kancelarive europiane dhe presidentit të Kongresit Amerikan mesazhin se shqiptarët do të luftojnë deri në fund për të qenë të lirë e të pavarur.

Ishte vetëm zëri shpëtimtar i Presidentit Ujllson që ndali projektin famëkeq europian për copëtimin e Shqipërisë. Për këtë arsye madhore, emri i Presidentit Ujllson është i skalitur në memorien e çdo shqiptari.

Me zgjedhjen nga Kongresi i Lushnjës të Këshillit Kombëtar, fillon historia 100-vjeçare e parlamentarizmit shqiptar.

Veprimtaritë e 100-vjetorit nisin nesër paradite me ceremoninë në shtëpinë e Kongresit të Lushnjës dhe do të vazhdojnë në Tiranë me përrurimin e ekspozitës, mandej me konferencën shkencore dhe me veprimtari të tjera në ditët, javët dhe muajt që vijojnë gjatë këtij viti, pasi i gjithë viti 2020 do të jetë viti i 100-vjetorit të parlamentarizmit shqiptar.

Sesioni i ri fillon pas një ngjarjeje të madhe tragjike, pas tërmetit të 26 nëntorit. Kjo situatë shërbeu si asnjëherë për të treguar humanizmin dhe solidaritetin e shqiptarëve kudo ndodheshin. Kjo ngjarje dëshmoi përgjegjësinë e lartë të Kuvendit dhe të qeverisë për t'iu përgjigjur me shpejtësi maksimale nevojave të familjeve të prekura dhe qytetarëve të pastrehë.

Gjej rastin të falënderoj gjithë deputetët, që në ato ditë të vështira iu gjendën pranë qytetarëve, jo si zgjedhës, por si motra e vëllezër në nevojë!

Dua të falënderoj qeverinë për mobilizimin, përgjegjësinë dhe kompetencën në përballimin e pasojave, për shpëtimin e jetës së njerëzve dhe

minimizimin e humbjeve njerëzore për strehimin e qytetarëve dhe marrjen e masave, si dhe mobilizimin e burimeve financiare për rindërtimin e banesave!

Vlerësoj, gjithashtu, edhe qëndrimin e opozitës, e cila përmbi interesat politike dhe elektorale vuri solidaritetin dhe humanizmin për të dëmtuarit nga tërmeti.

Siç edhe kam përmendur, sesioni i kaluar ka qenë një sesion produktiv: 59 projektligje të depozituara, 40 ligje, 66 vendime, 3 rezoluta të miratuara, 6 akte normative me fuqinë e ligjit në ndihmë të të prekurve nga tërmeti, 66 vendime për zgjedhje ose emërime, miratimi i 25 ligjeve më shumë me konsensus të opozitës, 202 diskutime të opozitës kundrejt 198 të maxhorancës, 2 interpelanca dhe 27 kërkesa për informacion është bilanci i shkurtër statistikor për sesionin e kaluar.

Edhe gjatë këtij sesioni reforma në drejtësi përbënte një nga prioritetet tona më të rëndësishme. Puna u përqendrua në ndërtimin dhe bërjen funksionale të organeve të reja të qeverisjes së sistemit. Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor po vijojnë me përmbushjen e funksioneve të parashikuara nga Kushtetuta dhe raportojnë rregullisht në Kuvend për gjendjen e sistemit dhe veprimtarinë e tyre. Kuvendi është kujdesur posaçërisht që në buxhetin e vitit 2020 të parashikohen fondet e nevojshme për funksionimin normal të këtyre institucioneve.

Në 5 dhjetor 2019, nën drejtimin e Presidentit të Republikës, u hodh shorti dhe u zgjodhën 9 anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë për vitin 2020. Këshilli na ka përcjellë listën e kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, të cilën, sipas vendimit që mori Konferenca e Kryetarëve sot, do ta shqyrtojmë dhe do ta votojmë në këtë seancë të sesionit parlamentar.

Kuvendi në seancën plenare të datës 11 nëntor zgjodhi zonjën Elsa Toska dhe zonjën Fiona Papajorgji anëtare të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese, pavarësisht kontestimeve ligjore e debatit publik, ka filluar nga funksionimi dhe është drejt ndërtimit të saj të plotë. Në seancën plenare të datës 5 dhjetor Kuvendit zgjodhi zotin Olsjan Çela Prokuror të Përgjithshëm.

Në datën 25 nëntor 2019 Këshilli i Lartë i Prokurorisë emëroi 8 prokurorë të SPAK-ut dhe zgjodhi drejtuesin e tij.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në datën 19 dhjetor vendosi fillimin e funksionimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të cilat funksionojnë respektivisht me 12 dhe 6 gjiqtarë.

Pas mbledhjes së Këshillit Europian të 17-18 tetorit, ku nuk u arrit të vendosej çelja e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, Kuvendi shprehu qëndrimin se ky vendim, sado i padrejtë, nuk na dekurajoi, por na shtoi përgjegjësinë dhe detyrimet për integrimin europian të Shqipërisë.

Në letrat dërguar të gjithë kryeparlamentarëve të vendeve anëtare të BE-së dhe në takimet me kryeparlamentarët e disa vendeve skeptike, i ftova të gjithë homologët të vijnë në Shqipëri dhe të prekin nga afër rezultatet, problemet dhe vështirësitë tona.

Në tetor, së bashku me zotin Balla, u takuam në Bruksel me Presidentin e Parlamentit Europian, Sassoli, dhe siguruam mbështetjen e këtij institucioni të rëndësishëm, mbështetje që u shpreh me një rezolutë të miratuar nga Parlamenti Europian dhe, gjithashtu, njoftoi Kuvendin se në javën e parë të muajit shkurt Presidenti i Parlamentit Europian do të vizitojë Shqipërinë dhe do të jetë i pranishëm në këtë sallë për t'iu drejtuar deputetëve shqiptarë.

Të njëjtat mesazhe dhashë në konferencën e kryeparlamentarëve të vendeve anëtare të Këshillit të Europës në tetor, menjëherë pas mbledhjes së Këshillit Europian. Ne, si Kuvend, hartuam planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Kuvendin në raportprogresin e vitit 2019 të Komisionit Europian për Shqipërinë, me 6 objektiva dhe 44 masa për periudhën maj 2019-maj 2020.

Komisioni për Integrimin Europian i Kuvendit gjatë kësaj periudhe ka miratuar 5 projektligje për përafrimin, ose 3 projektligje më shumë, dhe ka propozuar 18 amendamente, ose 15 amendamente më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë shtator-dhjetor 2018.

Roli kontrollues i Kuvendit në çështjet e integritetit europian është forcuar përmes përdorimit më të shpeshtë e cilësor të instrumenteve të kontrollit parlamentar të

parashikuara në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit dhe në ligjin për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE.

Risi e vitit 2019, në drejtimin e forcimit të transparencës së Kuvendit në procesin e integritetit europian, është publikimi për herë të parë i *Newsletters* për çështjet europiane në faqen e internetit të Kuvendit çdo tre muaj.

Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore po punon për ndryshimet e kuadrit ligjor zgjedhor bazuar në rekomandimet e raporteve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e viteve 2013, 2015, 2017, në rekomandimet e institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet dhe të propozimeve të partive politike, që kanë marrë secila jo më pak se 1% të votave në zgjedhjet e fundit për Kuvendin.

Kuvendi zgjeroi objektin e veprimtarisë së Komisionit, duke përfshirë fillimin e diskutimit politik, për të garantuar një proces të rregullt e të barabartë zgjedhor; ashpërsimin e dënimeve për shitblerjen e votës; eliminimin e keqpërdorimit të burimeve shtetërore gjatë fushatës dhe transparencën e listave të zgjedhësve. Ky proces është gjithëpërfshirës, duke marrë opinionin e të gjitha partive politike parlamentare dhe joparlamentare, si dhe partive opozitare, deputetët e të cilave kanë lënë mandatin e deputetit.

Siç jeni në dijeni, u arrit konsensusi midis të gjithë faktorëve politikë, parlamentarë dhe joparlamentarë, qeveri dhe opozitë, për të kryer reformën zgjedhore brenda datës 15 mars 2020 dhe mandej të vazhdohet rruga për diskutimin dhe miratimin në Kuvend.

Ndër arritjet në kontrollin e mbikëqyrjes parlamentare ishte bërja funksionale e platformës ndërinstitucionale *online*, e cila tashmë mund të aksesohet në faqen e Kuvendit. Platforma krijon një dimension të ri të kontrollit parlamentar dhe ndikon direkt mbi institucionet e pavarura dhe ekzekutivin.

Në platformë gjenerohet i plotë informacioni për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura adresuar ekzekutivit, duke evidentuar qartë kush dhe çfarë nuk ka realizuar.

Shërbimi i Monitorimit hartoi dhe botoi përmbledhjen "Monitorimi nga Kuvendi i Shqipërisë i institucioneve të pavarura gjatë vitit 2018", duke vënë theksin në mënyrë të veçantë

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 20 JANAR 2020

në vlerësimet dhe rekomandimet më të rëndësishme të Kuvendit lidhur me punën e secilit institucion.

Të nderuar kolegë,

Ky sesion duhet dhe do të jetë sesioni i punëve të mbaruara, kantierin e të cilave e kemi hapur që në fillim të kësaj legjislature.

Mbi bazën e arritjeve të sesionit të kaluar, por edhe të nevojave të zhvillimit të vendit, forcimit të demokracisë dhe institucioneve dhe mirëqenies së qytetarëve, gjatë këtij sesioni parlamentar ne duhet të përqendrohemi në këto prioritet kryesore:

- Objektivi ynë themelor dhe numër një do të jetë çelja e negociatave të anëtarësimit në ose para muajit maj të këtij viti. Ne funksion të këtij objektivi:

- Do të punojmë për zbatimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit 2019 të Komisionit European.

- Do të hartojmë e miratojmë Planin Strategjik të Kuvendit për periudhën 2020 - 2025, i cili do të përfshijë rritjen e rolit të Kuvendit në procesin e integritetit.

- Do të rishikojmë ligjin për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit, me qëllim parashikimin e një mekanizmi të ri për mbikëqyrjen e veprimtarisë së qeverisë gjatë procesit të negociatave, bazuar në praktikën më të mira europiane.

- Do të rrisim transparencën dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile.

- Do të fuqizojmë kapacitetet dhe do të modernizojmë shërbimet e Kuvendit në procesin e integritetit.

Objektiv tjetër do të jetë përfundimi i reformës zgjedhore brenda muajit mars, pas konsensusit të arritur me opozitën parlamentare e joparlamentare, për të garantuar një sistem zgjedhor funksional e të drejtë, administrim zgjedhor transparent e korrekt, konkurrencë zgjedhore të ndershme dhe sjellje elektorale dinjitoze, demokratike e përfundimtare.

Gjatë sesionit të ri do të përfundojë ngritja dhe plotësimi i të gjitha organeve të sistemit të drejtësisë dhe këto organe do të fillojnë të japin drejtësi për qytetarët.

Kuvendi i Shqipërisë do të kontribuojë që sistemi i ri i drejtësisë, i pastruar nga vetingu, të mos jetë zoti i qytetarëve, por në shërbim të tyre, jo një sistem grabitqar, por një sistem i drejtë, jo

një sistem në shërbim të pasurimit të një kaste, por i zhvillimit të vendit për një shoqëri të shëndetshme e mirëqenie për të gjithë.

Gjatë këtij sesioni do të rishikojmë, do të plotësojmë dhe do të miratojmë ligje të reja në fushën e marrëdhënieve me natyrën, shfrytëzimin e burimeve natyrore e mjedisit për të harmonizuar legjislacionin antisizmik dhe atë për përballimin e fatkeqësive natyrore, si zjarret, përmbytjet me legjislacionin dhe kodet europiane.

Legjislacioni i ri duhet të parashikojë rregulla të rrepta për ndërtimet, verifikimin e aftësive përballuese të ndërtesave ekzistuese, sidomos atyre të institucioneve publike, edukimin me kulturën antisizmike të popullsisë dhe kushtet ligjore e financiare për sigurimin e banesave.

Ne nuk mund ta sundojmë natyrën, por duhet të parandalojmë devijimin me ligjet, rregulloret e veprimet tona të ligjësive natyrore dhe prishjen e ekuilibrit të saj.

Ne nuk mund të hartojmë një legjislacion që parandalon dukuritë natyrore, por që minimizon rreziqet dhe dëmet e shkaktuara prej tyre.

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Sesioni i ri ka një risi me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës së Kuvendit.

Sistemi i ri i votimit, që do të fillojmë të zbatojmë nëpërmjet ekranit dixhital, që e ka secili deputet në tavolinë, ofron mundësi të mëdha që deputetët të njihen online me të gjithë dokumentacionin që do të shqyrtohet e miratohet në seancat plenare.

Përveç racionalizimit ekonomik dhe kujdesit mjedisor, sistemi i ri i votimit mundëson integrimin e platformës *e-parlament* edhe në seancën plenare dhe rrit aksesin e deputetëve në informacion dhe ecurinë e tyre.

Ky sistem është investimi i parë i Kuvendit në bashkëpunim edhe me projektin “Për mbështetjen e Kuvendit dhe edukimin qytetar”, i cili financohet nga qeveria zvicerane, zbatohet nga OSBE-ja dhe Instituti Demokratik Kombëtar Amerikan. Ky projekt synon zbatimin e disa aspekteve të kontrollit parlamentar dhe të procesit legjislativ të komisioneve parlamentare sipas përvojave më të mira të funksionimit të Bundestagut gjerman.

Këto ishin, të nderuar kolegë, disa çështje, të cilat mendova të ndaja me ju në fillimin e sesionit të ri.

Ju faleminderit dhe uroj një sesion produktiv!

Siç ramë dakord edhe në Konferencën e Kryetarëve, cili nga kryetarët e grupeve dëshiron të përshëndetë seancën?

Po, zoti Musaj.

Nimet Musaj - Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë dhe ministra,

Është kënaqësi t'ju uroj në fjalën time të parë për këtë legjislaturë suksese ju dhe të gjithë popullit shqiptar!

Rrënimet mund të jenë të pjesshme, por ringritjet e pjesshme janë rrënimet të ardhshme, ndaj për ringritje të plota duhet të jemi bashkë, opozitë dhe maxhorancë, patjetër që këtu kam parasysh edhe opozitën jashtëparlamentare.

Këto, të nderuar kolegë, janë fjalët që, për të qenë korrekt në citimin e vetes sime, i gjeta në procesverbalet e diskutimeve parlamentare të seancës së datës 5 dhjetor të vitit të kaluar. Në atë seancë unë përshëndeta reagimin e Kryeministrit Rama që u gjend në kohë rekord dhe i kudondodhur në zonat e prekura nga tërmeti, aq sa përshëndeta edhe qëndrimin konstruktiv të kryetarit të opozitës jashtëparlamentare, zotit Basha.

Në atë seancë u shpreha sinqerisht se po dilja kundër instinktit tim prej politikani, instinkt i cili ishte kundër këtij përafrimi, ku logjikshëm instinkti i çdo politikani të ulur në gjysmën tjetër të kësaj sale nuk sheh një voli nga afrimi i maxhorancës së këtushme me opozitën e atjeshme. Unë e dija që ringritja e Durrësit, e Thumanës, e Lezhës, e Laçit dhe e Mamurrasit, pa ringritjen e komunikimit dhe të vetëdijes së klasës politike, do të ishte një ringritje e pjesshme.

Pra, siç e thashë në paragrafin që shkëputa nga fjalët e mbajtura këtu e një muaj më parë, ajo ringritje e pjesshme mund të ishte rrënim i të ardhmes e më shumë. Në instinktin e politikanit, si djallë i komunitetit çam, vetes i kam servirur dhe i kam rezervuar instinktin e kombëtaristit. Këtë të fundit e ndiej sidomos në këtë sesion të ri parlamentar për shkak të vetëzhvillimeve të pritshme, por edhe të atyre në proces, që prekin si vendin tonë, aq edhe shqiptarët e rajonit, pra dua, duhet dhe ndiej se duhet ta theksoj më

shumë këtë gjë. Kombi ynë është në një moment kyç dhe shumë delikat, gati historik; e ritheksoj, gati historik.

Mali i Zi po kalon ditë të trazura dhe ato janë një faturë e kripur e një shteti që zgjodhi të jetë përgjithmonë perëndimor në mesin e një rajoni, ku, sa herë Europa tregohet e pavëmendshme, ndikimet e largëta apo të kundërta me të zënë rrënjë atje. Jashtë këtyre zhvillimeve nuk ka si të mos jenë edhe shqiptarët tanë në Malin e Zi, por, për fatin e mirë, mbi sipërfaqen e zhvillimeve dhe në fokusin e zhvillimeve të atjeshme, pavarësisht gjithçkaje, mbizotëron agjenda perëndimore, e për këtë duket se kthim pas nuk ka më.

Në Maqedoninë e Veriut kemi më shumë shqiptarë në politikë, në biznes, në administratë, në polici dhe në ushtri, kemi politikanë shqiptarë dhe përdorimin e gjuhës shqipe në parlament, kishim një kryetar parlamenti dhe uroj ta kemi sërish, e ku shqiptarët e pjesës perëndimore etiketohen specifikisht si faktorë properëndimorë dhe marrin deri edhe përshëndetjet me dedikim të vetë Presidentit të Parlamentit, zotit Sasoli, siç ndodhi në nëntorin e vitit të kaluar. Duke dëgjuar edhe fjalën e Kryetarit të Kuvendit, zotit Ruçi, do të kemi kënaqësinë që në datën 3 shkurt zoti Sasoli të jetë pranë nesh dhe të na përshëndesë, të nderuar deputetë!

Hapat e tyre, të ngjashëm me agjendën tonë, janë të pakthyeshëm drejt agjendës europiane. Në Kosovë ka vështirësi, që uroj të jenë momentale e të kapërcehen sa më shpejt të jetë e mundur. Kosova duhet të ketë qeveri dhe qeverisje e t'i rikthehet sa më parë dialogut me Serbinë, sa më parë diplomacisë proaktive, të konkretizojë lëvizjen e lirë pa viza dhe agjendën europiane.

Ata, të nderuar kolegë, zhvilluan një fushatë zgjedhore model për Ballkanin, zhvilluan një numërim dhe proces zgjedhor model, ata patën një rezultat shembull dhe meritojnë që këtë rrugë të shkëlqyer ta konkretizojnë me një qeverisje të shkëlqyer, që të gjenerojë të gjitha energjitë e atij vendi fund e krye properëndimor dhe proamerikan.

Shqipëria jonë, të nderuar kolegë, është në majën e agjendës perëndimore të zgjerimit. Komisioni ka sugjeruar një metodologji të re zgjerimi që na favorizon dhe Këshilli në mars do të diskutojë për të. Zoti Valei dhe zonja Van der

Leyen kanë shprehur optimizëm për pozicionet e skeptikëve të deridjeshëm të Holandës dhe Francës. Ambasadori i Bashkimit European në Shqipëri, zoti Soreka, na dha edhe më shumë shpresë me fjalët e tij, që konfirmojnë mbështetjen e pakushtëzuar të Parlamentit dhe të Komisionit European për agjendën europiane të Shqipërisë.

Nuk më mbetet veçse që deri në mbledhjen e Këshillit në mars Shqipëria të përcjellë mesazhe të qarta optimiste se jo vetëm pret, por edhe se e ka merituar dhe e meriton hapjen e negociatave.

Në valën e këtyre zhvillimeve afrimi i maxhorancës së këtuashme me opozitën e atjeshme është një zhvillim shpresëdhënës dhe vlerësues.

Reforma elektorale duhet të shkojë përpara, sepse është një karburant i mirë për shpejtësinë që i nevojitet integritetit european, shkuarjes drejt Europës. Në këtë pikë unë kam përshëndetjet më të përzemërta për këtë zhvillim, që është puna më me mend deri më sot, por edhe nga instikti i politikanit, edhe nga meraku i kombëtaristit dua t'ju them diçka nga kjo foltore, për të cilën dua dhe uroj që koha të mos më japë të drejtë. Ajo çfarë duhet t'ju them është se çfarëdo formule zgjedhore, çfarëdo formati, çfarëdo sistemi zgjedhor, çfarëdo arnimi dhe çfarëdo ndërhyrje me dakordësi të brendshme nëse nuk përfshihet në dokument fryma e çdo teksti që na ofron ekspertiza e partnerëve ndërkombëtarë, do të biem aty ku ishim, nga ngërçi në ngërç. Cila është kjo frymë që nënlexohet nga tekstet e propozuara nga partnerët?

Të nderuar kolegë, është demokratizimi i partive shqiptare, sot që na siguron që të kemi qeverisje demokratike nesër; vetëm demokratizimi i partive sot na siguron që ne nuk do të kemi opozita bllokuese nesër; vetëm demokratizimi i partive sot na siguron që politika do të qëndrojë afër zgjedhësve nesër; vetëm demokratizimi i partive sot sjell në parlament zërin e qytetarëve, cilado qofshin formulat përzgjedhëse të tyre; vetëm demokratizimi i partive sot, forcon dhe përmirëson parlamentin nesër.

Deri më tani, për fatin e keq, unë nuk e kam lexuar ende vullnetin e asnjërës palë. Megjithatë, për fatin e mirë, kemi ende kohë.

Së fundi, përsëri për fatin e mirë, nuk kemi më distancat e vitit të kaluar. Këtu dua ta mbyll fjalën time.

Të nderuar kolegë deputetë, ju uroj juve dhe këtij parlamenti sesion sa më të mbarë! Qoftë ky sesioni i lajmeve të mira në mars nga Këshilli, në maj nga Samiti i Zagrebit dhe më tej për vendin tonë Shqipërinë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Musaj!

Nga Grupi Demokrat kush e do fjalën? Po, zonja Hajdari.

Rudina Hajdari – Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë, që na ndiqni sot, dita e nesërme shënon 100-vjetorin e parlamentarizmit shqiptar. Kongresi i Lushnjës ishte pa dyshim kongresi i shpëtimit të Shqipërisë. Fundi i Luftës së Parë Botërore e rrezikoi shumë copëtimin e Shqipërisë. Në Konferencën e Parisit ekzistenca e Shqipërisë ishte në një pikëpyetje të madhe. Po ashtu duhet të ishte edhe përgjigja e shqiptarëve, të cilët me një vendim të madh hodhën hapat e parë të shtetit shqiptar. Kështu ndodhi më 21 janar të vitit 1920 ku burra shtetarë, patriotë, idealistë dhe intelektualë u bashkuan nga çdo krahinë e Shqipërisë për të shpëtuar shtetin shqiptar dhe për të mbrojtur tërësinë e territorit tonë, në atë kongres ata ngritën për herë të parë shtetin modern shqiptar, hodhën themelet e para të parlamentarizmit dhe morën vendime të rëndësishme politike, që kishin të bënin me fatin e vendit tonë. Ata u shprehën që me çdo kusht do të mbronin shtetin tonë dhe se e donin vendin më shumë se çdo njeri tjetër, që mundahej të punonte dhe të joste shqiptarët për copëtimin e saj. Kjo është një nga ngjarjet më të shënuara të shtetit shqiptar.

Figurat si: Sulejman Delvina, Iliaz Vrioni, Abdi Toptani, Aqif Pashë Elbasani, Ahmet Zogu, Mehmet Konica, Sotir Peçi, Luigj Bumçi, Idhomene Kosturi dhe Shefqet Koleci, ishin pa dyshim disa figura të mëdha që më pas u bënë shumë të rëndësishëm për historinë e Shqipërisë.

Mithat Frashëri shpeshherë e citonte këtë ngjarje dhe shkruante se kjo ngjarje ishte një kandil dhe dritë që duhet të ndriçojë kurdoherë kur Shqipëria ndodhet në errësirë, duhet të ndriçojë në çdo të keqe, në çdo kohë dhe në çdo rast. Të mbajturit mend të akteve të mëdha të patriotizmit është një lumturi për ne dhe një detyrë e madhe.

Të dashur qytetarë, që na ndiqni, kjo ngjarje e rëndësishme na bën të reflektojmë për vitin që kaluam. Viti që kaluam ishte i vështirë për sa u përket zhvillimeve politike në vend, ku dominoi kriza politike dhe aventurat e saj me jetën e shqiptarëve, vërtet e bënë Shqipërinë edhe më të cunguar.

Në këtë kontekst intimidues, besoj se angazhimi ynë në parlament ka qenë kyç dhe i ka shërbyer vendit. E them këtë sepse, pavarësisht përbaltjes për ta delegjitimuar këtë institucion bazë të demokracisë, i cili ka 100 vjet ekzistencë, duhet patjetër që ai të respektohet. Mendoj se puna jonë në parlament po fillon të japë të frytet e saj. Me mbajtjen e mandatit parlamentar, unë besoj përlësisht se bashkë me kolegët e opozitës i kemi shërbyer vendit tonë me aq sa kemi mundur. Patjetër që disa cinikë vazhdojnë ta paragjykojnë këtë qëndrim, por ne kemi qëndruar fort, duke i shërbyer agjendës euroatlantike të vendit.

Shqiptarët gjatë vitit 2019 kanë përjetuar sërish në mënyrë të padrejtë një jetë të vështirë dhe stresuese në familjet e tyre. Ndërkohë që e ardhmja e shqiptarëve vihet gjithnjë në pikëpyetje në Shqipëri, neve na takon t'u japim atyre një alternativë të qartë. Unë mendoj se demokracia e vendit tonë i është nënshtruar në mënyrë të vazhdueshme testimit, por ne sot duhet të largohemi nga tendencat autoritare dhe nga papërgjegjshmëria e plotë politike që përjetuam vitin e kaluar. Unë mendoj se dalja nga kjo krizë duhet të vijë nëpërmjet reformave të mëdha që i ka ndërmarrë tashmë vendi. Dy reformat që vërtet duhet t'u japin shpresë shqiptarëve, ku ata vërtet kanë pritshmëri të larta, janë pikërisht: reforma në drejtësi dhe reforma zgjedhore.

Gjatë muajve të fundit angazhimi ynë si deputetë të opozitës jo vetëm në seancat plenare, por edhe në Komisionin e posaçëm të Reformës Zgjedhore, ka qenë pikërisht që ne të hapim debatin e madh për ndryshimin e sistemit, për përfshirjen e të gjithë aktorëve relevantë për të ndryshuar atë që ne duam t'u japim shqiptarëve: rikthimin e parlamentit të shqiptarët. Me këtë rast, unë dua t'i falënderoj të gjithë, sigurisht edhe opozitën jashtëparlamentare, e cila më në fund pranoi të ulet bashkë me ne për të riformuar sistemin zgjedhor. Falë këtij angazhimi, ku reforma zgjedhore të jetë kryefjalë, konstatoj me

kënaqësi se nëse kjo reformë mbështetet fort nga BE-ja, SHBA-të dhe OSBE-ja, ne do të jemi në gjendje t'u japim shqiptarëve një reformë zgjedhore të besueshme. Gjithsesi, kjo reformë nuk duhet të mbetet peng dhe retorikë, që të kthehet në një alibi për një pazar të radhës. Ne sot duhet t'u rikthejmë shqiptarëve besimin te vota dhe t'u japim mundësinë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në parlament.

Gjithashtu, dua të shpreh kontributin që ka dhënë shoqëria civile në të gjitha reformat që ka ndërmarrë vendi, sidomos për reformën zgjedhore. Unë dua t'u shpjegoj shqiptarëve edhe arsyen pse u ula në atë tryezë javën e kaluar. Unë u ula aty pikërisht për t'u garantuar atyre se reforma zgjedhore do ta reformojë sistemin dhe do t'u japë besim të plotë shqiptarëve për votën që do të hedhin nesër, që ata të jenë në gjendje të zgjedhin dhe jo thjesht të votojnë.

Kjo betejë do të bëhet akoma edhe më e fortë në muajt në vijim. Për këtë do t'u garantoj dhe ju siguroj që ne nuk do të cedojmë në asnjë lloj pike. Për ne kjo është pika më e rëndësishme dhe do të luftojmë fort deri në fund. Kuptohet që ne nuk do të bëhemi bllokues për procesin e integritetit evropian të vendit. Nga ana tjetër, nuk do të lejojmë që reforma zgjedhore të përdoret për pazarin e radhës në kurriz të shqiptarëve. Unë ju siguroj se, për aq kohë sa ne të jemi në këtë parlament, angazhimi ynë do të jetë në funksion të kësaj agjende dhe në bashkëpunim të ngushtë me SHBA-të dhe me BE-në, ne do t'i bëjmë një reformim të thellë reformës zgjedhore dhe do të kërkojmë sistemin më të duhur për shqiptarët. Në angazhimin tonë ne kemi nevojë për më shumë mbështetje nga qytetarët. Gjithashtu duhet të intensifikojmë bashkëpunimin tonë me të gjitha grupimet e shoqërisë civile, që ekzistojnë jashtë parlamentit shqiptar. Ne po përjetojmë qartësisht një krizë të thellë të shtetit, veçanërisht institucioni i votës. Kjo është e patolerueshme për një vend që aspiron Bashkimin Evropian. Zhvillimi ekonomik, demokratik dhe shoqëror i Shqipërisë vazhdon të mbetet peng i krizave të njëpasnjëshme politike, të cilat janë produkt i drejtpërdrejtë i sistemit zgjedhor dhe i tjetërsimit të votës.

E ritheksoj se reforma zgjedhore nuk duhet të jetë më produkt i pazarit politik të radhës midis dy partive, mbi supet e shqiptarëve, por

duhet të bazohet në vullnetin e gjerë për të ndryshuar sistemin zgjedhor dhe për t'u dhënë shqiptarëve të drejtën për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre.

Ne duhet të testojmë çfarë duan qytetarët shqiptarë dhe t'u japim të drejtën, ndoshta edhe përmes një referendumi apo përmes çdo lloj forme tjetër. Shumica dërmuese e shqiptarëve kanë pritshmëri të larta dhe ne duhet të tregojmë kurajë dhe guxim për t'u përgjigjur pritshmërive të tyre.

Ka ardhur koha që bashkërisht, (e kemi për detyrë historike), t'u japim shqiptarëve institucione që do t'u kthejnë besimin, siç e meritojnë. Para së gjithash, ne duhet ta mbrojmë vendin tonë, të rikthejmë shpresën dhe perspektivën e sigurt ekonomike, për të ndaluar sa më parë emigracionin, që po dëmton të ardhmen e vendit tonë.

Qytetarët duhet të zgjedhin me lista të hapura njerëzit që duan dhe mendojnë se mund t'i përfaqësojnë denjësisht.

Në fund të fjalës sime dua t'u kujtoj shqiptarëve se e drejta e tyre për të votuar do të rikthehet sërish në këtë parlament dhe ne do t'u japim atyre përsëri të drejtën e sovranitetit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Hajdari!

Nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste fjalën e ka zoti Balla.

Taulant Balla - Viti 2019 ishte tejet i ngarkuar për Kuvendin, por më shumë se kaq, për vendin, me shumë momente të vështira. Për gjeneratën time, apo për më të rinj se unë dhe kolegët e mi, tërmeti i 26 nëntorit ishte një moment tejet tragjik, që do të na shoqërojë gjithë jetën, me 51 të vdekur, rreth 1000 të plagosur dhe me mijëra familje që në ato sekonda tmerri humbën gjithçka kishin. Ditët pas tërmetit ishin ditë të mbushura me solidaritet, me humanizëm, me duar të shtrira drejt njëri-tjetrit dhe me bashkimin e shqiptarëve si rrallë herë.

Faza e parë e emergjencës tashmë është mbyllur kudo; sytë, mendja dhe kërkesat janë të rindërtimi.

Ne si Kuvend, si grup i shumicës parlamentare, duam të jemi bashkë me ju për të nxirur qeverinë të mos humbasë asnjë ditë kohë për të përmbyllur pritshmëritë e të gjithë

shqiptarëve për përmbylljen e procesit të rindërtimit në një kohë sa më të shpejtë.

Ne si Kuvend jemi të gatshëm që së bashku me qeverinë të ndryshojmë tërësisht legjislacionin që ka të bëjë me ndërtimin, me sigurinë sizmike dhe me garancinë që duhet të plotësojë çdo ndërtesë për kriteret sizmike, duke nisur së pari, me ndryshimin tërësor të eurokodeve të ndërtimit. Koha po tregon që duhen riparë e përshtatur.

Në fund të vitit Kuvendi i Shqipërisë miratoi një sërë aktesh të lidhura tërësisht me trajtimin e familjeve të prekura, për pensionet e veçanta, si dhe miratim fondin më të madh në historinë e buxhetit tonë për ndërtimin e banesave të reja.

Viti i ri 2020, që sapo ka nisur, duhet të mbahet mend gjatë si viti i rindërtimit dhe i ringritjes, pas dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i 26 nëntorit. Brenda vitit 2020 çdo familje jashtë qytetit, që ka humbur banesën individuale, duhet të ketë hyrë në banesën e re. Po ashtu, deri në gjysmën e parë të vitit 2020, në të gjitha qytetet, ku tërmeti shkatërroi shumë banesa, duhet të jenë ngritur kantieret e lagjeve të reja.

Zonja dhe zotërinj,

Pa dyshim që viti 2019 do të mbahet mend edhe si një vit ku reforma në drejtësi bëri hapa të rëndësishëm përpara. Nëse në fillim të vitit 2019, jo vetëm në këtë sallë, kjo pjesë e djathtë e sallës, por edhe jashtë saj, kishte plot skepticizëm lidhur me çuarjen përpara të reformës në drejtësi, unë dua t'ju them që në dhjetor të vitit 2019 Prokuroria Speciale Antikorrupsion ishte në detyrë, Gjykata Kushtetuese tashmë ka numrin e mjaftueshëm për të vijuar një pjesë të detyrave të veta funksionale dhe sot ne ngremë edhe institucionin tjetër të rëndësishëm, që përfshin parlamentin, pasi kemi zgjedhur Prokurorin e Përgjithshëm vetëm pak javë më parë, dhe kështu përmbyllem një cikël të rëndësishëm të detyrave dhe të përfshirjes së Kuvendit në implementimin dhe zbatimin e reformës në drejtësi.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Viti 2020 ka nisur me një qasje të re të disa prej partive të opozitës ndaj institucioneve demokratike legjitime në vend. Edhe pse i vonuar, me shumë muaj e shumë energji të humbura kot, ndryshimi 180 gradë i qasjes së opozitës, duke u rikthyer në tryezën e dialogut,

është pa dyshim një reflektim pozitiv. Shqipëria ka nevojë që opozita ta ketë kuptuar përfundimisht se kursi i dhunës dhe moskompromisit nuk janë zgjidhja e duhur, por e gabuar. Kuvendi me votën edhe të shumicës, por edhe të opozitës parlamentare i ka krijuar prej muajsh mundësinë opozitës jashtë parlamentit që të ketë një vend në Komisionin Parlamentar të Reformës Zgjedhore. Përmes vendimit të Kuvendit të vitit 2019, këtij përfaqësuesi i janë krijuar ligjërisht kushtet që të ketë të drejta të barabarta me bashkëkryetarët nga maxhoranca dhe nga opozita parlamentare, duke përfshirë edhe të drejtën e vetos. Deri tani opozita jashtëparlamentare e kishte refuzuar Komisionin Parlamentar të Reformës, ashtu sikurse edhe vendin e caktuar përmes vendimit të Kuvendit. Ekspertët e Komisionit Parlamentar të Reformës kanë paraqitur deri tani të gjitha amendamentet, që trajtojnë çështjet dhe rekomandimet të OSBE-ODIHR-it. Gjithsesi, Komisioni, jo pa qëllim, nuk kaloi asnjë amendim në votim, me synimin që t'i krijojë të gjitha mundësitë edhe opozitës jashtëparlamentare që të gjejë një mekanizëm si të kontribuojë e të japë konsensusin e vet për reformën. Falë këtij reflektimi opozita jashtëparlamentare u ul në një tryezë me bashkëkryetarët e Komisionit Parlamentar të Reformës, zonjën Hajdari dhe zotin Gjikhuri, të cilët dua t'i falënderoj veçanërisht për një punë shumë të mirë dhe produktive që kanë bërë deri tani.

Dua t'ju ritheksoj se qëllimi ynë është përmbyllja e kësaj reforme më 15 mars 2020, duke shfrytëzuar kështu të gjithë hapësirën ligjore që është krijuar me vendimin e Kuvendit të vitit 2019. Draftet e propozuara me ekspertët në Komision duhet të diskutohen edhe në tryezën politike, që përfshin jo vetëm Komisionin, por edhe përfaqësuesit nga opozita jashtëparlamentare të caktuar nga PD-ja dhe LSI-ja. Draftet e dakordësuara në këtë nivel do të kalojnë sipas Rregullores dhe Kushtetutës në procedurën parlamentare, atë të Komisionit Parlamentar të Reformës dhe më pas në seancën plenare. I gjithë kuadri i mekanizmit të dakordësuar në marrëveshjen e javës së shkuar nuk përbën një procedurë ekstraparlamentare, por përforcon atë çka është e shkruar që në vendimin e Kuvendit për ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore që në vitin

2019, kur u krijua hapësira ekstra për opozitën jashtëparlamentare. 15 marsi është afati i fundit. Më 14 mars ju ftoj në Elbasan për Ditën e Verës dhe më 15 mars votojmë reformën zgjedhore.

Çështja tjetër që dua të ngre bashkë me ju sot ka të bëjë pikërisht me atë që maxhoranca jonë ka si objektiv. Ne, të dashur kolegë të opozitës, duam të kemi mbështetjen tuaj për reformat e rëndësishme që duhet të çojmë përpara, por pa asnjë dyshim ne do të vijojmë angazhimin tonë qeverisës përmes mbështetjes së disa prioritetëve me legjislacionin e duhur. Ndër to, dua që në këtë fillim sesioni të kujtoj se synimi ynë në këtë 1 vit e gjysmë të mbetur të këtij mandati të dytë, që do të jetë një punë e rëndësishme për të garantuar mandatin tonë të tretë qeverisës, pikë e parë dhe objektiv i ynë themelor do të jetë përshkallëzimi i luftës kundër krimit dhe korrupsionit. Shumë shpejt do të sjellim në Kuvend një bazë ligjore për t'u përmirësuar në funksion të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për sa i përket të dytës, ne do të mbështesim ndryshimet e nevojshme ligjore të konsultuara me partnerët tanë për t'i dhënë Policisë së Shtetit atributet e mjaftueshme ligjore për një luftë me efektivitet të lartë kundër krimit të organizuar.

Viti 2020 duhet të mbahet mend jo vetëm si viti i rindërtimit pas shkatërrimeve që solli tërmeti i 26 nëntorit, por edhe si viti i vënies përpara lupës së ligjit të çdo pasurie që buron nga krimi dhe nga trafiket e çdo lloji. Ne do ta mbështesim qeverinë edhe me akte të tjera ligjore, që përmirësojnë shërbimet *online* për qytetarët, reformat në sektorin e rëndësishëm të energjisë. Duhet, gjithashtu, të përmbylлим, me ndryshimet e nevojshme në legjislacion, edhe historinë e gjatë të legalizimeve. Ne shumë shpejt do të sjellim në Kuvend një paketë, e cila do të garantojë që beteja e fituar në mandatin tonë të parë me 180 mijë objekte të legalizuara të vijojë dhe të mbyllet me rreth 100 mijë objekte të tjera, të cilat nuk mund të legalizohen për shkak të ndalimeve që ka ligji aktual, por që do të regjistrohen në një regjistër të veçantë në kadastër dhe, sa herë që shteti të ketë nevojë për të zhvilluar projektet e infrastrukturës së vet, këta banorë do të dëmshpërblehen për objektin e tyre.

E fundit, por po kaq e rëndësishme, është edhe qasja jonë për sa i përket vijimit të "Paktit

për universitetin”. Qeveria do të investojë për t’i modernizuar universitetet tona, ndërkohë që ne si Kuvend dhe si grup parlamentar i shumicës jemi të gatshëm të mbështesim çdo hap që do të hedhë qeveria në drejtim të ruajtjes së këtij partneriteti të rëndësishëm që kemi me universitetin për ta zhvilluar atë dhe për t’u garantuar të gjithë studentëve jo vetëm kampuse të mira universitare, por sigurisht, edhe një vlerë më të mirë të diplomës që ata marrin.

Të nderuar kolegë dhe kolege të Kuvendit, pa asnjë dallim, majtas ose djathtas, më lejoni t’ju uroj një sesion të mbarë parlamentar! Nën frymën e një bashkëpunimi të konsoliduar për çështje të rëndësishme të vendit, të shpresojmë se gjatë këtij sesioni parlamentar Shqipëria të fillojë bisedimet për anëtarësim me Bashkimin Europian dhe kontributi nuk është vetëm yni, por i të gjithë shqiptarëve.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, zoti Murrizi, për procedurë!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë!

Meqenëse keni ndërruar televizorët, nga Iliria i keni bërë *Samsung*, ngrita dorën, sepse nuk ia qëllova dot kësaj veglës. Në këtë kuadër tenderi, shtoni edhe një karrige, sepse keni shtuar ministrat. Nuk më erdhi mirë kur ia vodhët karrigen ministrit të Brendshëm. Shikoni se si e keni lënë!

Nesër është 100-vjetori i parlamentarizmit shqiptar. Do të nderonim veten si parlament, meqenëse patëm fatin të ishim në këtë sallë në këtë 100-vjetor të fillimit të parlamentarizmit shqiptar (jo Kongresit të Lushnjës, sepse ai Kongres e ka vendin e nderit në histori prej 100 vjetësh dhe ata burra, që u mbledhën në vitin 1920 në Lushnjë, nuk kanë nevojë që t’i vlerësojmë ne, sepse kanë 100 vjet që kanë bërë histori: kanë ruajtur këtë shtet që kemi ne sot), dhe do t’i jepnim dinjitet vetes jo Kongresit të Lushnjës që ta kishim votuar përpara se të shkojmë nesër atje për të nderuar 100-vjetorin e Republikës, të parlamentarizmit dhe të themeleve reale të shtetit shqiptar. Dua që gjatë këtij viti t’u jepnim mundësi qytetarëve shqiptarë në këtë 100-vjetor që të vijnë në këtë sallë burra dhe gra nga vota e tyre dhe jo vëmje nga xhepat e kryetarëve të partive shqiptare.

Sa për kthesën që tha kolegu parafolës për opozitën jashtëparlamentare, i nderuar koleg, nuk është kthesë 180-gradëshe, rri pa merak, është rrafshatë! Ishallah kanë rënë butë dhe nuk u thyhet shtylla kurrizore! E di se atje ju ka ngelur sahati, te dashuria e parë! Por thojni edhe atyre që, pasi keni tri palë zgjedhje që i fshiheni votës së qytetarëve, të mos dërdëllisni në emër të popullit dhe të qytetarëve shqiptarë! Hajdeni, se ka ardhur momenti që në atë 15 mars të kthejmë demokracinë dhe t’i japim vlerë sovranit, votës së atyre që, realisht, duhet të sjellin të zgjedhurit e tyre në këtë sallë!

Sa për Ditën e Verës, i nderuar koleg, deri në datën 6 mars unë dhe ti së bashku ramë dakord në Konferencën e Kryetarëve se do t’i rishikojmë festat. Nuk i dihet, se festë pagane është, qesh Ulsiu, a do të lëmë ose jo, për Elbasanin mund të jetë festë lokale...

(*Bie gongu*)

Por më e rëndësishme se festa e ballokumes është 21 janari i vitit 1920!

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Murrizi!

Është e disata herë që ky problem ngrihet nga ju. Por, në fakt, jo vetëm nga ju, po edhe nga kolegë të tjerë deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, pasi është një kërkesë e drejtë, e ligjshme. Siç kemi thënë edhe në Konferencën e Kryetarëve, është më se e domosdoshme që Kuvendi të marrë për shqyrtim dhe të shikojë në tërësinë e tij të gjithë ligjin “Për festat zyrtare” dhe në këtë kuadër të trajtohet edhe ky problem.

(*Pasi lexon rendin e ditës.*)

Fillojmë sipas radhës...

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Urdhëroni!

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Nuk ka diskutime për çështje jashtë rendit të ditës, pasi sot hapet sesioni parlamentar.

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Vazhdojmë me rendin e ditës. Ka vërejtje për procesverbalin?

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Po, çfarë vërejtjeje?

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Lidhur me procesverbalin, kam dy këshillime për administratën: të ketë vëmendjen gjatë kohës që flasin deputetët.

Së pari, unë nuk e përdor fjalën “zog nëne”, por “Zot nëne”.

Së dyti, kur dua të përdor fjalën “burg”, e përdor ndonjëherë edhe “burq”, sepse burq i themi ne ku fusim kafshët në momente të caktuara.

Kjo ishte në lidhje me procesverbalin e seancës së kaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë ke që e tund kokën ti?! Nuk të pëlqen?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk të pëlqen ty?

Gramoz Ruçi – Vazhdojeni fjalën tuaj! Mos flisni me deputetët!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi – Zoti Kryetar, faleminderit, por mbaji të paktën në qetësi sot këta në 100-vjetor! Edhe gjatë kohës që folën kolegët e tjerë, bëjnë si ato grenzat xanxare! Boll, o burrë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Nuk ka vërejtje të tjera.

Miratohet procesverbali.

Njoftime

Nga Këshilli i Ministrave janë depozituar dy akte normative me fuqinë e ligjit dhe shtatë projektligje.

Nga deputetët janë depozituar katër projektligje dhe një kërkesë për interpelancë.

Nga Presidenti i Republikës janë depozituar dy dekrete për rishqyrtim ligji.

Nga Akademia e Shkencave është depozituar projektvendimi për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për këtë institucion.

Nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 27.12.2019 i është përcjellë Kuvendit lista me pesë kandidatë të përzgjedhur dhe të renditur në bazë të meritave për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, çështje për të cilën Konferenca e Kryetarëve, siç ju thashë, ra dakord ta kemi sot në rendin e ditës për të përmbushur detyrimin kushtetues lidhur me afatin.

Në cilësinë e Kryetarit të Kuvendit kam emëruar në delegacionin e përhershëm të Kuvendit të Shqipërisë pranë Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit të Bashkimit Europian-Shqipëri deputeten Mirela Kumbaro në vend të deputetit Arben Ahmetaj.

Të gjithë listën e titujve të çështjeve të depozituara në Kuvend e keni përpara. Materialet, si gjithmonë, do t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Siç ju thashë, sot u mbledh Konferenca e Kryetarëve dhe mund t'ju njoftoj se me konsensus ajo diskutoi draftprogramin e punës dhe draft-kalendarin 3- javor për periudhën në vijim. Në Konferencë pati konsensus, për pasojë, në mbështetje të neneve të Rregullores, programi dhe kalendar i njoftohen Kuvendit. Materialet do t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Për sa i përket paraqitjes në Kuvend të kalendarit për raportet vjetore të organeve kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj për periudhën e vitit 2019, sot Konferenca e Kryetarëve, në mbështetje të nenit 103, pika 1, të Rregullores, diskutoi edhe kalendarin e raporteve vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për veprimtarinë e tyre për vitin 2019. Pas sugjerimeve që u bënë nga anëtarët e Konferencës së Kryetarëve, Konferenca vendosi miratimin e kalendarit që keni të gjithë përpara në tavolinat e punës. Në mbështetje të nenit 103, pika 2, ky kalendar i njoftohet seancës plenare. Të gjithë kalendarin do ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Vazhdojmë me projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin 86/2017 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit, të ndryshuar”.

Me propozim të kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zotit Balla, deputetja Milva Ekonomi, caktohet kryetare e Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, në vend të deputetit Arben Ahmetaj. Ndërsa deputetja Mirela Kumbaro caktohet zëvendëskryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Hapet votimi për prezencën.

Ju lutem, meqë është hera e parë me këtë sistem votimi, ka ndonjë koleg që ka probleme me votimin?

Mbyllet votimi.

Janë 110 deputetë prezentë.

Hapet votimi me elektronikë për dy propozimet e bëra.

Gramoz Ruçi – Vazhdoni votimin, ju lutem!

Mbyllet votimi!

108 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet!

Projektvendim “Për zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Në mbështetje të nenit 147/d të Kushtetutës dhe nenit 201, pika 2, shkronja “f”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, nga lista e pesë kandidatëve të përzgjedhur e të renditur mbi bazën e meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej tre të pestave për asnjë prej kandidatëve brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e listës, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar.

Renditja e kandidatëve, sipas vendimit të Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, rezulton si vijon:

- 1-Artur Metani
- 2-Sokol Stojani
- 3-Joana Asimi Sorraj
- 4-Eris Hysi
- 5-Lindita Troja.

Para se të kalojmë në procedurën e votimit, ju njoftoj se deputetja Gjermani ka deklaruar se ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në lidhje me këtë çështje, dhe në mbështetje të neneve të Rregullores e të Kodit të Sjelljes, deputeti nuk ka të drejtë të votojë për një projektligj apo një dokument tjetër, kur ka konflikt interesi.

Deklarata e saj me shkrim është depozituar dhe publikuar në internet, në faqen zyrtare të Kuvendit.

Para se të kalojmë në procesin e votimit, hapim edhe një herë votimin për verifikimin e kuorumit.

Hapet edhe një herë votimi për prezencën.

Dëgjon IT-ja? Hapet votimi për prezencën.

(Ndërhyrje nga salla)

Jo, s’e ka hapur.

Edhe një herë prezencën, ju lutem, sepse është vendim me shumicë të cilësuar.

Mbyllet votimi.

112 deputetë prezentë. Është kuorumi i dëshiruar, që mundëson vazhdimin e procesit të votimit.

Procedura e votimit do të jenë pesë votime, secila më vete. Votimi do të zhvillohet me elektronikë. Votimi është i fshehtë. Duhet të paktën 84 vota pro për miratimin e cilësdo kandidate apo e cilitdo kandidat që ndodhet në listë.

Fillojmë votimin për kandidatin e parë.

Hapet votimi i fshehtë me elektronikë për zotën Artur Metani.

Mbyllet votimi.

98 vota pro, 8 kundër, 9 deputetë nuk kanë votuar.

Hapet votimi me elektronikë për zotën Sokol Stojani.

Mbyllet votimi.

16 pro, 19 abstenime, 68 kundër, 12 nuk kanë votuar.

Hapet votimi me elektronikë për zonjën Joana Hasimi Sorraj.

Mbyllet votimi.

10 pro, 20 kundër, 71 abstenime dhe 14 nuk kanë votuar.

Hapet votimi për zonjën Eris Hysi.

Mbyllet votimi.

9 pro, 72 abstenime, 16 kundër, 18 nuk kanë votuar.

Hapet votimi me elektronikë për zonjën Lindita Troja.

Mbyllet votimi.

12 pro, 15 kundër, 71 abstenime.

Sipas votimit shpallet Inspektor i Lartë i Drejtësisë, pasi mori shumicën e votave të domosdoshme sipas Kushtetutës dhe ligjit organik, zoti Artur Metani.

Në mbështetje të nenit 202 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë para se të fillojë detyrën betohet para Kuvendit të Shqipërisë në një ceremoni publike. Siç e shikoni, zoti Metani është paraqitur në foltore për të bërë betimin.

Unë do të lexoj formulën e betimit. Formula e betimit është: “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do të qëndroj kurdoherë besnik i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale”.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 20 JANAR 2020

Artur Metani - Betohem!
Gramoz Ruçi - Urime!

Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.
Seanca tjetër do të njoftohet.

(Seanca u mbyll në orën 18:30)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**